



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1095/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Hamid Guri, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1095/2021, i paraqitur nga Hamid Guri, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin ka kërkuar rinumërim e fletëvotimeve në vendvotimet: 0708D/01D dhe 0713D/02R për kandidatët e kuvendit komunal në Kaçanik, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK).

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1095/2021 (përmes postës më datë 04.11.2021), nga Hamid Guri, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Kaçanikut, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me të cilin pretendon se gjatë numërimit të fletëvotimeve në Vendvotimin disa nga fletëvotimet janë shpallur të pavlefshmeve vetëm pse tiku ka kaluar katrorin. Më tej në apel parashtruesi pretendon se në Vendvotimin 0713D/02R, ka pasur parregullsi dhe manipulime gjatë numërimit të votave dhe shton se si pasojë e kësaj votat e tij

nuk i figurojnë në rezultate të KQZ-së. Kërkon që të rinumërohen votat në Vendvotimet: 0708D/01D dhe 0713D/02R. Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, në bazë të të cilave ka kërkuar rinumërim të fletëvotimeve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi deklaratat e komisionerit dhe të vëzhguesit të bashkangjitur në apel nga ana e ankuesit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme për të konkluduar se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtruesit të apelit nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr 1095/2021 më datën 09.11.2021

Kryesuese e Panelit



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.